



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACIONI I MONITORIMIT TË BUXHETIT

PËR

4 MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

PËRMBAJTJA

1- HYRJE

1.1 Misioni i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit

1.2 Fushat e Përgjegjësisë Shtetërore

1.3 Programet Buxhetore

2- INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

3- PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

4- PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 Performanca Financiare e Programit Buxhetor

4.2 Performanca Jo Financiare e Programit Buxhetor

4.3 Veprimet vijuese në Nivelin e Programit Buxhetor

5- PROJEKTET KAPITALE

6- NDRYSHIMET NË BUXHET

7- PËRFUNDIMI

1. HYRJE

1.1 MISIONI

Misioni i Ministrisë është të hartojë dhe zbatojë politika të qëndrueshme për zhvillimin dhe promovimin e turizmit, mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe art-kulturore, si dhe nxitjen e aktivitetit fizik dhe sportit, me synim rritjen e mirëqenies ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit dhe forcimin e imazhit të tij në nivel ndërkombëtar.

1.2 FUSHAT E PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në zbatim të VKM nr. 516, datë 25.09.2026, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

- a) Harton dhe zbaton politikat për turizmin;
- b) Harton dhe zbaton politikat e qeverisë në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale, duke përfshirë ruajtjen dhe promovimin e kulturës së shkruar, nxitjen e krijimtarisë artistike dhe industrive krijuese, zhvillimin e edukimit kulturor, mbrojtjen dhe rijetësimin e vlerave kulturore, si dhe rritjen e dialogut e të shkëmbimit kulturor në kuadër të integritetit evropian dhe ndërkombëtar, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;
- c) Harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, harton politikat mbrojtëse e promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar.
- ç) Harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale.

Ky dokument ofron informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit për periudhën janar – prill 2026, bazuar në:

- Ligjin nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”;
- Shkresës së Ministrisë së Financave nr. 18216/111 prot., datë 15.01.2026 “Miratimin e detajimit të buxhetit të shpenzimeve korrente për vitin 2026”;
- Shkresës së Ministrisë së Financave nr. 2776/1 prot., datë 10.03.2026 “Miratimin e detajimit të buxhetit 2026-2028 të shpenzimeve kapitale”.

Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar – prill 2026, mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit, me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit. Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës MTKS do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit. Forma

dhe përmbajtja e raporteve të monitorimit u krye sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar gjatë përgatitjes së raportit zhvilloi komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të varësisë të MTKS-së, me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të qartë të arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës raportuese.

1.3 PROGRAMET BUXHETORE

Në zbatim të ligjit 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", MTKS menaxhon 6 programe buxhetore si vijon:

1. PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM - 01110;
2. ARTI DHE KULTURA – 08230;
3. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË – 08220;
4. ZHVILLIMI I TURIZMIT – 04760;
5. ZHVILLIMI I SPORTIT – 08140;
6. MBËSHTETJE PËR FËMIJËT DHE RININË – 08610.

Në zbatim të ligjit 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", buxheti 2026 për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit është në vlerën 7,392,950,000 lekë, i detajuar sipas shpenzimeve:

- | | |
|--|--------------------|
| • Shpenzime korrente | 4,729,795,000 lekë |
| • Shpenzime kapitale | 2,663,155,000 lekë |
| <i>nga të cilat:</i> | |
| ○ <i>shpenzime kapitale me financim të brendshëm</i> | 2,243,155,000 lekë |
| ○ <i>shpenzime kapitale me financim të huaj</i> | 420,000,000 lekë |

Plani pësoi ndryshime shtesë në nivel klasifikimi buxhetor në kuadër të miratimit nga Ministria e Financave:

- ✓ Akordimit të fondit të veçantë në vlerën 4,000,000 lekë.

2. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për periudhën e 4 Mujorit të I, për vitin 2026, në nivel programi buxhetor, paraqitet si në tabelën më poshtë:

në lekë

Emri i Grupit	Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit	Kodi i grupit 12			
		Plani Fillestar Vjetor Viti 2026	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2026	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	% e realizimit
Shpenzimet sipas programeve buxhetore					
Kodi i Programit	Emërtimi				
1110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	396,800,000	397,600,000	102,922,625	25.9%
8220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	1,155,878,000	1,156,978,000	217,820,926	18.8%
8230	Arti dhe Kultura	3,800,718,000	3,802,218,000	447,866,151	11.8%
8140	Zhvillimi i Turizmit	919,100,000	919,500,000	85,200,658	9.3%
4760	Zhvillimi i Sportit	834,600,000	834,700,000	747,332,411	89.5%
8610	Mbështetje për Fëmijët dhe Rininë	285,854,000	285,954,000	36,694,828	12.8%

Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01,02,03,04,05,08,22)	7,392,950,000	7,396,950,000	1,637,837,599	22.1%
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)			938,097	
Totali Shpenzimeve të Ministrisë	7,392,950,000	7,396,950,000	1,638,775,696	22.1%

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për periudhën raportuese për vitin 2026, sipas klasifikimit ekonomik, paraqiten si në tabelën më poshtë:

në lekë

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit					
		Plani Fillestar Vjetor Viti 2026	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2026	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	% e realizimit
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik					
Artikulli	Emërtimi				
600	Paga	1,789,590,000	1,789,590,000	531,557,899	29.7%

601	Sigurime Shoqërore	292,285,000	292,285,000	87,307,389	29.9%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	765,035,000	765,035,000	123,053,469	16.1%
603	Subvencione				0.0%
604	Transferta Korente të Brendshme	1,375,626,000	1,390,466,000	494,775,425	35.6%
605	Transferta Korente të Huaja	456,515,000	441,675,000	391,284,793	88.6%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	50,744,000	54,744,000	884,873	1.6%
Nën-Totali Shpenzime Korrente		4,729,795,000	4,733,795,000	1,628,863,848	34.4%
230	Kapitale të Patrupëzuara	29,900,000	29,900,000		0.0%
231	Kapitale të Trupëzuara	2,213,155,000	2,213,155,000	8,705,781	0.4%
Nën-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		2,243,055,000	2,243,055,000	8,705,781	0.4%
230	Kapitale të Patrupëzuara		-	71,320	0.0%
231	Kapitale të Trupëzuara	420,000,000	420,000,000	196,650	0.0%
Nën-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj		420,000,000	420,000,000	267,970	0.1%
Totali Shpenzime Kapitale		2,663,055,000	2,663,055,000	8,973,751	0.3%
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor		7,392,850,000	7,396,850,000	1,637,837,599	22.1%
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)				938,097	

Për sa më lart, rezulton se realizimi i fondeve buxhetore për 4 mujorin e parë të vitit 2026 kundrejt planit të rishikuar të buxhetit 2026, është 22%.

Lidhur me rialokimet buxhetore për 4-mujorin e parë 2025, në nivel klasifikimi buxhetor, janë kryer:

- Për shpenzimet korrente:
 - 7 transferime në artikullin 606;
 - 3 transferime në artikullin 602;
 - 6 transferime në artikullin 604

Në zbatim të ligjit 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", numri maksimal i punonjësve i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit është 1.228 punonjës.

Në tabelën më poshtë paraqiten numri maksimal i punonjësve të shpërndarë në organikat e njësive shpenzuese të varësisë si dhe numri i punonjësve të pashpërndarë për organikat e reja të pazbardhura, por të miratuara me ligjet përkatëse.

NR.	ENT	M.L	KOD.INST	EMËR INSTITUCIONI	DEGË THESARI	NR. PUNONJËSVE
1	001	12	1012001	APARATI MTKS	3535	161
2	001	12	1012101	INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHEGIMISE KULTURORE	3535	58
3	001	12	1012002	DRTK BERAT	0202	24
4	001	12	1012103	DRTK TIRANE	3535	20
5	001	12	1012102	QENDRA MUZEORE DURRES	0707	15
6	001	12	1012004	DRTK GJIROKASTER	1111	30
7	001	12	1012005	DRTK KORÇE	1515	26
8	001	12	1012006	DRTK SHKODER	3333	22
9	001	12	1012070	DRTK VLORE	3737	36
10	001	12	1012010	MUZEU HISTORIK KOMBETAR	3535	45
11	001	12	1012014	QENDRA MUZEORE BERAT - MUZEU IKONOGRAFISE "ONUFRI", MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	0202	10

12	001	12	1012016	QENDRA MUZEORE KRUJE-MUZEU KOMBETAR "SKENDERBEU", MUZEU ETNOGRAFIK KRUJE	0716	11
13	001	12	1012018	MUZEU KOMBETAR TE ARTIT MESJETAR	1515	12
14	001	12	1012076	MUZEU KOMBETAR I PAVARESISE	3737	3
15	001	12	1012012	Q K V FOLKLORIKE	3535	6
16	001	12	1012020	INSTITUTI KOMBETAR I REGJISTRIMIT TE TRASHEGIMISE KULTURORE	3535	8
17	001	12	1012097	MUZEU KOMBETAR I FOTOGRAFISE "MARUBI"	3333	10
18	001	12	1012104	ZYRA ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TE PARQEV E ARKEOLOGJIKE APOLONI DHE BYLIS	0909	14
19	001	12	1012098	MUZEU KOMBETAR I PERGJIMEVE "SHTEPJA ME GJETHE"	3535	6
20	001	12	1012024	TEATRI KOMB. I OPERAS DHE BALETIT	3535	248
21	001	12	1012022	TEATRI KOMBETAR	3535	64
22	001	12	1012025	BIBLIOTEKA KOMBETARE	3535	92
23	001	12	1012009	QENDRA KOMBETARE KULTURORE PER FEMIJE	3535	30
24	001	12	1012021	GALERIA KOMBETARE E ARTEVE	3535	28
25	001	12	1012090	TEATRI KOMB. EKSPERIMENTAL "K.SPANHIVOGLI"	3535	21
26	001	12	1012015	ARKIVI QENDROR SHTETEROR I FILMIT	3535	10
27	001	12	1012092	CIRKU KOMBETAR	3535	38
28	001	12	1012100	QENDRA KOMBETARE E LIBRIT DHE LEXIMIT	3535	12
29	001	12	1012173	AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT	3535	42
30	001	12	1012174	AGJENCIA RAJONALE E BREGDETIT LEZHE	2020	8
31	001	12	1012175	AGJENCIA RAJONALE E BREGDETIT DURRES	0707	8

32	001	12	1012176	AGJENCIA RAJONALE E BREGDETIT VLORE	3737	8
33	001	12	1012177	AGJENCIA RAJONALE E BREGDETIT SARANDE	3731	8
34	001	12	1012178	AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT	3535	24
35	001	12	1012179	AGJENCIA KOMBËTARE E RINISE	3535	30
36	001	12	1012180	AGJENCIA E SHERBIMIT TË SPORTIT	3535	14
				NR. PUNONJESISH I PASHPERNDARE		26
				TOTALI		1228

3. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

3.1.1 Programi Buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim":

Treguesit e performancës në këtë program janë:

- ✓ Gra të përfaqësuara në nivele drejtuese të Aparatit të MTKS 29
- ✓ Raporti gra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MTKS 68%
- ✓ Raporti burra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MTKS 32%

3.1.2 Programi Buxhetor "Arti dhe Kultura"

Në programin buxhetor Arti dhe Kultura, ka patur një vëmendje më të madhe në drejtim të Genderit, duke mbështetur, **projekte të cilat trajtojnë barazinë gjinore**, të drejtat e gruas, emancipimin e saj etj. Më konkretisht elementi gjinorë është vendosur në nivel tregues performance përkatësisht në “Rritja dhe zhvillimi i audiencave në funksion të mbrojtjes së krijimtarisë dhe cilësisë artistike duke respektuar genderin dhe të drejtat e njeriut” dhe “Mbështetje e industrive krijuese **duke respektuar barazinë gjinore**, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi.

3.1.3 Programi Buxhetor "Zhvillimi i Sporteve":

Barazia gjinore në sport nënkupton garantimin e mundësive të barabarta për vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, në pjesëmarrjen, stërvitjen dhe konkurrimin sportiv. Në praktikë, kjo qasje nuk do të thotë ndarje, por **përfshirje të përbashkët, bashkëpunim dhe akses të barabartë në ekipet sportive dhe aktivitetet e organizuara.**

Në Shqipëri, **ekipet sportive shkollore dhe klubet sportive**, në bashkëpunim me federatat kombëtare, luajnë një rol kyç në realizimin e këtij parimi. Përmes programeve të zhvillimit sportiv në shkolla dhe komunitete, vajzat dhe djemtë angazhohen në mënyrë të balancuar në sporte ekipore si **volejboli, basketboli dhe futboli**, duke krijuar një mjedis ku të dy gjinitë zhvillojnë aftësi teknike, disiplinë dhe frymë bashkëpunimi.

Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) ka zgjeruar ndjeshëm përfshirjen e vajzave në futboll përmes krijimit të ekipeve të vajzave në nivel klubesh dhe shkollash, si dhe përmes kampionateve të moshave që identifikojnë talente të reja. Në të njëjtën kohë, ekipet e djemve dhe vajzave zhvillohen paralelisht, duke siguruar akses të barabartë në stërvitje, gara dhe infrastrukturë sportive.

Po ashtu, **Federata Shqiptare e Volejbollit** dhe **Federata Shqiptare e Basketbollit** organizojnë kampionate kombëtare për vajza dhe djem në grupmosha të ndryshme, ku ekipet sportive trajnohen sipas standardeve të njëjta dhe kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në gara rajonale dhe kombëtare. Klubet sportive lokale kontribuojnë në përfshirjen e hershme të fëmijëve në ekipe, duke inkurajuar pjesëmarrjen e përbashkët në fazat bazë të zhvillimit sportiv.

Në shumë raste, aktivitetet sportive shkollore dhe komunitare organizohen si **turne të hapura dhe gjithëpërfshirëse**, ku vajzat dhe djemtë marrin pjesë në të njëjtat evente, duke ndërtuar kulturën e bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë. Kjo qasje ndihmon në thyerjen e stereotipeve gjinore dhe në normalizimin e pjesëmarrjes së vajzave në sportet tradicionale të dominuara nga djemtë.

Në kuadër të iniciativës **#BeActive** dhe **Javës Evropiane të Sportit**, ekipet sportive nga shkollat, klubet dhe federatat marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta ku promovohet barazia gjinore përmes:

- turneve mikse dhe aktiviteteve rekreative;
- demonstrimeve sportive me pjesëmarrje të vajzave dhe djemve;
- aktiviteteve familjare sportive;
- fushatave ndërgjegjëse kundër diskriminimit gjinor;
- promovimit të sportistëve dhe sportistëve si modele të barabarta frymëzimi.

Në këtë mënyrë, ekipet sportive në Shqipëri shërbejnë si një platformë praktike për zbatimin e barazisë gjinore, duke krijuar një mjedis ku vajzat dhe djemtë zhvillohen së bashku, garojnë në mënyrë të drejtë dhe kontribuojnë në ndërtimin e një kulture sportive gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.1.1 Programi Buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	386,800,000	387,600,000	102,922,625	26.6
Shpenzime kapitale FB	10,000,000	10,000,000	-	-

Shpenzimet korrente në program shërbejnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Aparatit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar i vitit 2026 ka një rritje prej 800,000 lekë, që vjen nga akordimi fondit të veçantë.

Fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve është realizuar në masën 22%. Ky realizim vjen si pasojë e vakancave në personelin e MTKS-së gjatë periudhës raportuese, për shkak të mosplotësimit të disa pozicioneve të planifikuara.

Fondi për shpenzimet operative (art.602) të Aparatit të MTKS-së është realizuar në masën 47%. Shpenzimet janë kryer për shlyerjen e detyrimeve prioritare, si: shërbime postare, shërbime telefonike, sigurim dhe ruajtje objekteve, energji elektrike, karburant dhe vaj, siguracion të mjeteve të transportit, tatime dhe taksa të paguara nga institucioni, furnizime kancelarie dhe materiale zyre, shpenzime transporti dhe akomodimi, qira ambienteve, shërbime të transportit ajror, pagesa për dalje në pension ose për raste sëmundje.

Realizimi sipas produkteve buxhetore

91201AA - Numër raportesh/ aktesh ligjore dhe nënligjore të koordinuara, që konsiston në mbështetjen e stafit të drejtorive përkatëse në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore. Për 4 mujorin e 2026 janë hartuar 7 akte.

91201AB - Staf i trajnuar të cilat kanë synim të zhvillojnë trajnime për administratën me qëllim përmirësimin dhe rritjen e këtyre kapaciteteve, në përputhje me objektivat strategjike në këtë fushë. Për 4 mujorin e 2026 janë kryer 8 trajnime. Trajnime të kryera të cilat kanë synim përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve në përputhje me objektivat strategjike në këtë fushë.

Në shpenzimet kapitale janë planifikuar dy projekte investimi në vlerën 10,000,000 lekë.

Për periudhën raportuese nuk ka realizim të fondeve të investimeve. Mosrealizimi i këtyre fondeve lidhet me vijimin e procedurave administrative dhe teknike nga institucionet përgjegjëse, konkretisht nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare (DSHQ). Për rrjedhojë, fondet e planifikuara për këto projekte nuk janë angazhuar dhe likuiduar gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2026. Realizimi i tyre pritët të kryhet pas përfundimit të procedurave përkatëse dhe finalizimit të të gjitha proceseve administrative nga strukturat kompetente.

4.1.2 Programi Buxhetor "Arti dhe Kultura"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Arti dhe Kultura", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	1,582,563,000	1,584,063,000	441,219,020	27.9
Shpenzime kapitale FB	1,918,155,000	1,918,155,000	-	-
Shpenzime kapitale FH	300,000,000	300,000,000	-	-

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar i vitit 2026 ka një rritje prej 1,500,000 lekë që vjen nga akordimi i fondit të veçantë.

Në shpenzimet kapitale janë planifikuar 25 projekte investimi.

- ✓ Me financim të brendshëm prej 1,918,155,000 lekë.
- ✓ Me financim të huaj prej 300,000,000 lekë për 2 projekte.

Shpenzime Korente

- Për llogarinë ekonomike 600, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 878,761,000 lekë dhe Shpenzime faktike të periudhës 4 mujore janë 271,837,645 lekë, me realizim 31%.
- Për llogarinë ekonomike 601, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 144,040,000 lekë dhe Shpenzime faktike të periudhës 4 mujore janë 44,445,829 lekë, me realizim 31%.
- Për llogarinë ekonomike 602, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 121,550,000 lekë dhe Shpenzime faktike të periudhës 4 mujore janë 26,527,144 lekë, me realizim 22%.
- Për llogarinë ekonomike 604, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 407,500,000 lekë dhe Shpenzime faktike të periudhës 4 mujore janë 96,008,157 lekë, me realizim 24%.

- Për llogarinë ekonomike 605, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 30,424,000 lekë dhe Shpenzime faktike të periudhës 4 mujore janë 2,114,999 lekë, me realizim 7%.
- Për llogarinë ekonomike 606, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 1,788,000 lekë dhe Shpenzime faktike të periudhës 4 mujore janë 285,246 lekë, me realizim 16%.

Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm

- Për llogarinë ekonomike 231, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 1,918,155,000 lekë dhe nuk ka Shpenzime faktike për periudhën 4 mujore.

Shpenzime Kapitale me financim të huaj

- Për llogarinë ekonomike 231, Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 300,000,000 lekë dhe nuk ka Shpenzime faktike për periudhën 4 mujore.

Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06):

Shpenzimet Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06), për vitin 2026 janë në vlerën **938,097** lekë (fakt).

Përsa i përket, Shpenzimeve Korrente për Institucionet e varësisë, sqarojmë si më poshtë vijon:

- **91203AA → TKOBAP**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 613,828,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 200,432,486 lekë, me realizim 33%.

- **91203AB → TK**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 155,728,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 49,318,980 lekë, me realizim 32%.

- **91203AC → TKEKS**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 47,724,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 13,552,349 lekë, me realizim 28%.

- **91203AD → GKA**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 84,024,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 14,892,970 lekë, me realizim 18%.

- **91203AF → QKKF**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 68,198,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 18,733,544 lekë, me realizim 27%.

- **91203AG → Cirku Kombëtar**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 77,024,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 22,215,319 lekë, me realizim 29%.

- **91203AH → AQSHF**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 25,474,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 7,423,156 lekë, me realizim 29%.

- **91203AI → Biblioteka Kombëtare**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 157,880,200 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 48,413,614 lekë, me realizim është 31%.

- **91203AK → QKLL**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 39,390,216 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 10,556,278 lekë, me realizim 27%.

- **91203AJ → Aparati MK**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 60,644,578 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 23,009,024 lekë, me realizim 38%.

- **91203AL → Javët kulturore të huaja në Shqipëri**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 120,000,000 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 605,800 lekë, me realizim 1%.

- **91203AS → Thirrje Arti**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 109,347,006 lekë dhe Shpenzimet faktike të periudhës 4 mujore janë 32,065,500 lekë, me realizim 29%.

- **91203AR → Akte ligjore / nënligjore të miratuara**

Plani vjetor i rishikuar për Shpenzimet Korente për vitin 2026 është në vlerën 24,801,000lekë dhe nuk ka Shpenzime për periudhën 4 mujore.

Përsa i përket shpenzimeve kapitale, sqarojmë si se për 4 mujorin e parë të vitit 2026 nuk ka patur realizim për arsye se miratimi i tyre është bërë me shkresën nr. 2776/1 prot., datë 10.03.2026, gjë e cila kërkon kohë për realizmin e procedurave të prokurimit.

Raporti i performancës së produkteve të programit

Raporti i performancës së produkteve të programit lidhur me shpenzimet faktike të institucioneve të varësisë për 4 mujorin e parë të vitit 2026 janë si më poshtë:

- **91203AA** → **TKOPAB** 72 aktivitete dhe 200,432,486 lekë shpenzime faktike.
- **91203AB** → **TK** 62 aktivitete dhe 49,318,980 lekë shpenzime faktike.
- **91203AC** → **TKEKS** 119 aktivitete dhe 13,552,349 lekë shpenzime faktike.
- **91203AD** → **GKA** 400 vizitorë dhe 14,892,970 lekë shpenzime faktike.
- **91203AF** → **QKKF** 71 aktivitete dhe 18,733,544 lekë shpenzime faktike.
- **91203AG** → **Cirku Kombëtar** 63 aktivitete dhe 22,215,319 lekë shpenzime faktike.
- **91203AH** → **AQSHF** 35 aktivitete dhe 7,423,156 lekë shpenzime faktike.
- **91203AI** → **Biblioteka Kombëtare** 28 aktivitete dhe 48,413,614 lekë shpenzime faktike.
- **91203AK** → **QKLL** 3 projekte të brendshme dhe 10,556,278 lekë shpenzime faktike.

Për sa i përket ‘Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur’ 91203AJ → Aparati janë realizuar 79 aktivitete dhe 23,009,024 lekë shpenzime faktike, ndërsa për produktin “Thirrje Arti” 91203AS, janë mbështetur 29 përfitues dhe shpenzimet faktike janë në vlerën 32,065,500 lekë.

Javët kulturore të huaja në Shqipëri me kod 91203AL, janë mbështetur 2 përfitues dhe 605,800 lekë janë shpenzime faktike.

Sa i përket financimit të huaj janë parashikuar projektet me financim të huaj si:

- Projekti SEEDS (grant)
- Programi "Europa Krijuese"
- Fond i ngrire (Biletimi qendror Online),

Për të cilat shpenzimet faktike janë 0 lekë.

4.1.3 Programi Buxhetor "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	880,878,000	881,978,000	215,494,306	24.4
Shpenzime kapitale FB	175,000,000	175,000,000	0,0	0,0
Shpenzime kapitale FH	100,000,000	100,000,000	100,000,000	0,0

Në shpenzimet kapitale janë planifikuar 26 projekte investimi:

- ✓ Me plan të shpenzimeve kapitale prej 275,000,000 lekë.

Programin buxhetor “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë” ka në varësi 18 institucione.

Për vitin 2026 realizimi i fondeve buxhetore paraqitet:

Llogaria 604, kod produkti 91202AD – “Aktivitete të fushës së trashëgimisë jomateriale, me buxhet fillestar në masën 110,000,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 17,773,350 lekë, për:

- Ngjarje kulturore dhe krijuese- Festivale, Evente dhe Panaire/ mbështetje e programeve kulturore dhe organizatave
 - ✓ Gjithsej projekte fituese 77 projekte
 - ✓ Kontrata të lidhura deri në 30.04.2026 43 projekte
 - ✓ Evente në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve - Një seri performancash, ekspozitash, konferencash dhe prezantimesh nga institucionet kulturore, që reflektojnë punën e realizuar gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2026.

DRTK Gjirokastrë

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 53,228,500 lekë, buxheti i rishikuar është 53,335,500 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 14,600,681 lekë, ose 27.5 %.

Referuar llogarisë 602 “Evidentimi, ruajtja, mirëmbajtja, restaurimi, dhe promovimi i Monumenteve të Kulturës, pjesë e Trashëgimisë Kulturore, si dhe Qendrën Historike dhe zonën e mbrojtur të qytetit, pasuri e Trashëgimisë Botërore, UNESCO-s” janë realizuar:

Emërtimi i treguesit	Fakti i Vitit	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti i
	Paraardhës	Plan Fillestar	Plan i Rishikuar	Periudhës/ progresive
		Viti 2026	Viti 2026	
Evidentimi, ruajtja, mirëmbajtja, restaurimi, promovimi i Monumenteve të Kulturës, pjesë e Trashëgimisë Kulturore, si dhe Qendrën Historike dhe zonën e mbrojtur të qytetit, pasuri e Trashëgimisë Botërore, UNESCO-s.	15,969,796.88	20,524,000.00	20,631,000.00	3,181,806.31
Evidentimi, ruajtja, mirëmbajtja, restaurimi dhe promovimi i Monumenteve të Kulturës, pjesë e Trashëgimisë Kulturore, si dhe Qendrën Historike dhe zonën e mbrojtur të qytetit, pasuri e Trashëgimisë Botërore, UNESCO-s.				
Ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe restauruese ne objektet Monument Kulture	87	100	100	21
Hartim projketesh per mirëmbajtjen e Monumenteve te Kulturës	11	15	15	3
Inspektive në objekte Monument Kulture	95	90	90	20
Vendime të KKR-së, të miratuara për objektet Monument Kulture	40	30	30	18
Aktivitetet social -kulturore, organizuar në objekte Monument Kulture, ose në funksion të tyre	24	40	40	12
Trainime të ndryshme, kryer në funksion të objektit të aktivitetit	7	5	5	3

DRTK Berat

Buxheti i rishikuar i DRTK Berat për vitin 2026 është 29,907,600 lekë.

Realizimi për periudhën raportuese 2026 është 9,256,163 lekë ose 31%.

Gjate 4 mujorit të parë të vitit 2026:

- ✓ janë realizuar 10 mirëmbajtje/restaurime.
- ✓ janë hartuar 7 projekte.
- ✓ janë kryer 7 aktivitete kulturore dhe edukuese.

Restaurime dhe mirëmbajtje

Gjatë periudhës janar–prill 2026, DRTK Berat realizoi 10 ndërhyrje restauruese dhe mirëmbajtjeje në monumente kulture dhe objekte historike në Berat dhe zonat përreth. Ndërhyrjet përfshinë restaurimin e 2 ikonave, restaurime emergjente në 3 monumente dhe objekte historike, ndërhyrje restauruese në 2 kisha monument kulture, restaurim në 2 banesa monument kulture dhe restaurimin e 1 ure historike. Gjithashtu u krye pastrim periodik nga bimësia në territorin e Qendrës Historike. Vlera totale e ndërhyrjeve të realizuara arrin në rreth 81,144 lekë, ndërsa 2 procese restaurimi vijojnë ende.

Hartimi i projekteve

Në të njëjtën periudhë, specialistët e DRTK Berat hartuan 7 projekte restaurimi, konservimi dhe mirëmbajtjeje për monumente kulture dhe objekte tradicionale. Projektet përfshijnë 2 projekte restaurimi banesash tradicionale, 2 projekte restaurimi në monumente të kultit, 1 projekt konservimi monumenti historik, 1 paketë ndërhyrjesh emergjente parandaluese dhe 1 projekt mirëmbajtjeje emergjente. Të gjitha projektet janë realizuar nga specialistët e institucionit me kosto zero lekë për hartimin e tyre.

Aktivitete të organizuara

Gjatë muajve janar–prill 2026, DRTK Berat organizoi 7 aktivitete edukative dhe sensibilizuese me pjesëmarrjen e nxënësve nga të paktën 6 institucione arsimore. Aktivitetet përfshinë 2 vizita studimore në laborator restaurimi dhe monumente historike, 2 takime informuese mbi trashëgiminë kulturore, 1 punëtori edukative, 1 prezantim dokumentari dhe 1 aktivitet ndërinstitutional në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve. Përmes këtyre veprimtarive u promovuan vlerat historike, arkitektonike dhe kulturore të qytetit të Beratit dhe u nxit ndërgjegjësimi i brezave të rinj për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

DRTK Vlorë

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 56,115,000 lekë, buxheti i rishikuar është 56,145,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 16,736,257 lekë ose 29.8%.

Referuar shpenzimeve kapitale me financim të huaj, ka buxhet 653,000 lekë dhe realizim për periudhën raportuese në masën 176,232 lekë.

DRTK Korçë

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 31,381,500 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 10,686,948 lekë, ose 34%

Shpenzime kapitale janë në vlerën 4,000,000 lekë dhe realizuar në kuadër të projektit IPA Smart4You2 për periudhën 4 mujore në vlerën 2,058,650 lekë.

Gjatë periudhës janar–prill 2026 u realizuan me sukses 16 aktivitete në funksion të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, të përqendruara kryesisht në edukimin përmes kulturës dhe përfshirjen e komunitetit, veçanërisht të të rinjve. Njëkohësisht janë realizuar 32 inspektime në monumente kulturore. Aktivitetet përfshijnë orë të hapura mësimore në shkollë dhe në terren, vizita në qendra historike, muze dhe site arkeologjike, ekspozita tematike, punëtori krijuese dhe aktivitete ndërvepruese mbi artizanatin, veshjet tradicionale, ikonografinë, poezinë dhe historinë lokale. Po ashtu u organizuan veprimtari në kuadër të ditëve ndërkombëtare dhe kombëtare të trashëgimisë, kulturës, librit dhe muzeve, si dhe guida turistike, publikime dhe materiale promovuese. Këto iniciativa kontribuan në rritjen e ndërgjegjësimit kulturor, forcimin e identitetit lokal, nxitjen e dialogut ndërkulturor dhe promovimin e trashëgimisë si burim edukimi dhe zhvillimi.

DRTK Shkodër

Plani fillestar i buxhetit për vitin 2026 është 40,358,500 lekë, Plani i rishikuar është 40,415,750 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 11,648,158 lekë ose 28.8%

Referuar Art. 602 Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër ka kryer:

- ✓ Mirëmbajtje të monumenteve, hartim të projekteve mirëmbajtëse dhe restauruese, mbarëvajtja e sezonit turistik, përmirësimi i infrastrukturës në shtet e vizitueshme si dhe zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të edukimit nëpërmjet kulturës.
- ✓ Aktivitete që përfshijnë një gamë të gjerë nismash kulturore dhe edukative të zhvilluara në kuadër të programit “Edukimi përmes Kulturës”, të orientuara drejt fëmijëve, nxënësve dhe komunitetit të gjerë.

DRTK Tiranë

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 31,247,900 lekë dhe buxheti i rishikuar është 31,347,900 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 9,126,627 lekë, ose 29%.

DRTK Tiranë ka zhvilluar aktivitetet si më poshtë:

✓ Ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe restauruese ne objektet Monument Kulture	6
✓ Hartim projketesh per mirëmbajtjen e Monumenteve te Kulturës	7
✓ Inspektive në objekte Monument Kulture	150
✓ Vendime të KKR-së, të miratuara për objektet Monument Kulture	14
✓ Aktivitete social -kulturore, organizuar në objekte Monument Kulture, ose në funksion të tyre	12
✓ Trainime të ndryshme, kryer në funksion të objektit të aktivitetit	10

MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

Buxheti total i miratuar për vitin 2026 është 65,367,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 23,819,948 lekë, ose 36%.

Ekspozita dhe veprimtari të ndryshme

Gjatë periudhës 4-mujore 2026, janë realizuar 13-aktivitete me tematika të ndryshme të cilat janë kryer jashtë Muzeut Historik Kombëtar si dhe ekspozita lëvizëse duke ekspozuar objekte të historisë të vendit tonë në disa qytete, shkolla e bashki. Këto aktivitete janë organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim edhe me palë të tjera.

Anëtarësime Institucionale në Organizata Muzeore Ndërkombëtare e ballkanike.

Për të patur vazhdimësi në këto anëtarësime për vitin 2026 i janë planifikuar në buxhet 83,000 lekë nga të cilat gjatë periudhës 4-mujore është kryer pagesa për anëtarësimin e Muzeut Historik Kombëtar, në ICOM Albania (300 Euro=29,790 lekë) dhe në NEMO (300Euro= 29,790 lekë).

MUZEU KOMBËTAR I ARTIT MESJETAR

Buxheti total i miratuar për vitin 2026 është 22,528,500 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 8,023,100 lekë ose 35.6%.

MKAM ka realizuar për periudhën raportuese:

✓ Restaurimi në vepra arti	25
✓ Program edukimi mbi kulturen	49
✓ Ekspozita dhe aktivitete kulturore	1
✓ Fotografim, dizifektim dhe plotesim I database me cilesi bashkekohore	252

- ✓ Pjesmarrës në projekte dhe bashkëpunime (1. AADF “Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë ” Projekti “ACT4PRESPA” i cili financohet nga BE)

2

MUZEU KOMBËTAR I PAVARËSISË

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 7,474,500 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 2,504,062 lekë ose 33.5%.

MUZEU KOMBËTAR I PËRGJIMEVE “SHTËPIA ME GJETHE”

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 19,016,970 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 4,429,003 lekë ose 23%.

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore që mbart ky institucion, si dhe pritjen e vizitorëve, me qëllim njohjen dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi të kaluarën komuniste.

MUZEU KOMBËTAR I FOTOGRAFISË “MARUBI”

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 33,526,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 9,321,941 lekë, ose 27.8%.

QENDRA MUZEORE KRUJË

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 25,491,500 lekë, buxheti i rishikuar është 25,395,800 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 7,337,670 lekë, ose 28.8%.

QENDRA MUZEORE BERAT

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 35,715,500 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 9,344,856 lekë, ose 26%

Gjatë periudhës 4-mujore 2026, janë realizuar 40 aktivitete të përqendruara në edukimin përmes kulturës dhe përfshirjen aktive të komunitetit.

QENDRA MUZEORE DURRËS

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 41,212,500 lekë.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 10,228,419 lekë, ose 25%

1. Aktivitete edukimi

Gjatë periudhës raportuese u organizuan 4 aktivitete edukative dhe sensibilizuese mbi trashëgiminë kulturore, me pjesëmarrjen e nxënësve nga të paktën 5 institucione arsimore. Aktivitetet përfshinë takime letrare, bashkëbisedime, interpretime artistike, shfaqje filmi të animuar dhe aktivitete

edukimi informal në Torrën Veneciane dhe Amfiteatër. Në kuadër të këtyre veprimtarive u promovuan figura të rëndësishme të kulturës shqiptare, si dhe u ndërgjegjësuam fëmijët mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar.

2. Aktivitete promovimi të Trashëgimisë Kulturore

Në kuadër të promovimit të trashëgimisë kulturore dhe jetës artistike u zhvilluan 4 aktivitete kulturore dhe letrare në ambiente monumentale të qytetit të Durrësit. Aktivitetet përfshinë 2 mbledhje letrare dhe poetike, 1 ceremoni vlerësimi për shkollat 9-vjeçare të Bashkisë Durrës dhe 1 aktivitet artistik ndërkombëtar në Amfiteatër, në bashkëpunim me Aleancën Franceze. Përmes këtyre aktiviteteve u promovuan letërsia, arti dhe dialogu kulturor në hapësirat e trashëgimisë kulturore.

Z.A.K.P.A APOLONI DHE BYLIS

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 137,257,500 lekë.

Realizimi është në masën 42,334,000 lekë, ose 31%

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Buxheti i alokuar për vitin 2026 është 170,320,500 lekë, buxheti i rishikuar është 170,400,500 lekë. Realizimi i shpenzimeve korrente është në masën 30,465,771 lekë ose 18%.

4.1.4 Programi Buxhetor “Zhvillimi i Turizmit”

Realizimi financiar i programit buxhetor "Zhvillimi i Turizmit", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	829,100,000	829,500,000	85,200,658	10.3
Shpenzime kapitale FB	90,000,000	90,000,000	0,0	0,0
Shpenzime kapitale FH	0,0	0,0	0,0	0,0

Në shpenzimet kapitale janë planifikuar 6 projekte investimi.

4.1.5 Programi Buxhetor "Zhvillimi i Sporteve"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Zhvillimi i Sporteve", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	814,600,000	814,700,000	747,332,411	91,7
Shpenzime kapitale FB	0,0	0,0	0,0	0,0
Shpenzime kapitale FH	20,000,000	20,000,000	0,0	0,0

Në shpenzimet kapitale me financim të huaj janë planifikuar 2 projekte investimi.

4.1.6 Programi Buxhetor "Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	235,854,000	235,954,000	36,716,828	15,6
Shpenzime kapitale FB	50,000,000	50,000,000	0,0	0,0
Shpenzime kapitale FH	0,0	0,0	0,0	0,0

Në shpenzimet kapitale janë planifikuar 2 projekte investimi.

4.2 PERFORMANCA JO FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.2.1 Programi Buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim"

Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrim" ka si objektiv funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore, krijimin e një stafi permanent dhe sa më të qëndrueshëm, aplikimin e proceseve

transparente të konkurimit në përputhje me parimet e barazisë gjinore, motivimin për ngritjen në detyrë sipas rezultateve, me qëllim rritjen e standardeve dhe performancës së punës.

Treguesit e performancës në këtë program janë:

✓ Gra të përfaqësuara në nivele drejtuese të Aparatit të MTKS	29
✓ Raporti gra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MTKS	68%
✓ Raporti burra ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MTKS	32%

Ky informacion është përlllogaritur mbi numrin faktik të punonjësve pasi struktura e plotë prej 161 punonjësish është e pa plotësuar akoma.

4.2.2 Programi Buxhetor "Arti dhe Kultura"

Programi "Arti dhe Kultura" është një nga programet e Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet të cilit zbatohen politikat e programit qeverisës, për evidentimin, promovimin, mbrojtjen, forcimin e vlerave kulturore Kombëtare dhe mbikëqyr format e realizimit të tyre sipas parametrave të përcaktuara në politikë si dhe bazuar në dokumentet strategjike të sektorit. Programi dikton dhe zhvillon politika në mbrojtje të krijimtarisë dhe industrive krijuese, skenës së pavarur, respektimit e genderit, të të drejtave të njeriut, në mbështetje të grupeve të marginalizuara dhe diversitetit kulturor në rang vendi. Ky program, zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën, si dhe 9 institucioneve në varësi të saj, (Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar, Galeria Kombëtare e Arteve, Biblioteka Kombëtare, Cirkus Kombëtar, Qendra Kulturore për Fëmijë, Teatri Kombëtar Ekseprimental "Kujtim Spahi vogli", Qendra Kombëtare e Librit, Arkivi Shtetëror Shqiptar i Filimit, etj).

Arti dhe Kultura orientohet drejt programeve strategjike dhe kreative në art-kulturë e në veçanti mbështet Programin “Edukimi përmes Kulturës, hartuar në përputhje me platformën e UNESCO-s. Qëllimi i këtij bashkëpunimi dhe partneriteti është zbatimi me sukses i këtij programi, i cili bazohet në nevojën për bashkëpunim të institucioneve të artit, trashëgimisë kulturore dhe institucioneve arsimore, të shtrira në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.3 Treguesit e performancës

Treguesit e performancës në nivel objektiv për programin e art-kulturë janë, përkatësisht:

1. Përqindja e programeve artistike të realizuara;
2. Përqindja e nismave të ndërmara për përmirësimin e sistemit të menaxhimit strategjik dhe fiskal të institucioneve artistike;
3. Përqindja e Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore;
4. Përqindja e veprimtarive të realizuara me institucionet e art-kulturës;
5. Përqindja e veprimtarive të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë, (aparati);

6. Fuqizimin dhe promovimin e kalendarit me natyrë turizmin kulturor;
7. Përqindja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimeve në programe dhe evenimente ndërkombëtare/Diplomacia Kulturore:

Treguesi i parë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e programeve artistike të realizuara, të cilat kanë krijuar hapësira krijuese në funksion të zhvillimit të artit dhe kulturës në vend që nga viti 2023, kur ka filluar edhe zbatimi i Strategjisë së Kulturës. Ky tregues është kumulativ dhe duhet të ketë trend rritës. Mbështetur në këtë Strategji, synohet që deri në 2026, të jetë rritur ndikimi i politikave të artit dhe kulturës në përmirësimin e jetës social kulturore, nxitjes së krijimtarisë artistike që në moshë të herët dhe qasja/integrimi i shumë të rinjve përmes programeve të edukimit kulturor.

Treguesi i dytë i performancës në nivel objektiv mat përqindjen e numrit aplikimeve/projekteve dhe bashkëpunimeve kulturore brenda dhe jashtë vendit të mbështetura, të cilat trajtohen nëpërmjet skemave të financimit nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, program “Arti dhe Kultura”. Gjithashtu mat trendin e masave të marra për hapësirat e reja dhe mekanizmat transparente për financimin e subjekteve që veprojnë në fushat e artit, letërsisë dhe kulturës.

Treguesi i tretë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e numrit të ambienteve / godinave të rikonstruara infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësirat e reja të rikualifikuara.

Treguesi i katërt i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e trendit në përmirësimin e shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike. Mat trendin rritës të pasurimit të kalendarëve artistikë si dhe zgjerimin e shtrirjes gjeografike në të gjithë territorin e RSH.

Treguesi i pestë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e numrit të aplikimeve të mbështetura nga thirrja vjetore si dhe numrin e projekteve të realizuara si prioritete të brendshme.

Treguesi i gjashtë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e numrit të aktiviteteve të realizuara me natyrë turizmin kulturor duke fuqizuar dhe promovuar shtrirjen gjeografike kulturore në rang vendi, përgjatë sezonit turistik.

Treguesi i shtashtë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen përfaqësimeve ndërkombëtare të produktit artistik shqiptar elitare në arenën ndërkombëtare, përmes institucioneve qendrore të artit dhe kulturës në vend, në zbatim të marrëveshjeve kulturore ndërkombëtare si dhe artistëve shqiptar që jetojnë në Diasporë.

4.2.3 Programi Buxhetor " Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë"

Programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë është një nga programet e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, i cili synon ruajtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e saj si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehje e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive.

Trashëgimia Kulturore përbëhet nga vlera materiale të luajtshme dhe të paluajtshme (dëshmi të arkitekturës, peizazhit, arkeologjisë) dhe vlera jo materiale që përbëjnë dijen dhe përvojën shpirtërore (ritet, zakonet, zejet tradicionale, folklori dhe gjuha) të krijuar dhe transmetuar nga populli përgjatë shekujve.

Ky program zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si dhe nëpërmjet 18 institucioneve në varësi të saj (si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Muzetë Kombëtarë, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Zyrat e KA Parqet Arkeologjike, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, etj.) në mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve financiare shtetërore dhe bashkëpunimeve me organet e qeverisjes vendore, partnerë ndërkombëtarë dhe PPP si dhe rritjen e aksesit të publikut në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor të qëndrueshëm.

Performanca jo buxhetore e programit

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor

Gjatë vitit 2026, IKTK u angazhua në hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018. Në këtë kuadër u miratuan 4 vendime të rëndësishme të Këshillit të Ministrave për deklarimin dhe administrimin e pasurive kulturore të paluajtshme, përfshirë Parkun Arkeologjik Bylis dhe Klos, Parkun Arkeologjik Orikum, Zonën Arkeologjike Bushat dhe një ansambël arkitektonik urban në qytetin e Delvinës.

2. Partneritete dhe marrëveshje bashkëpunimi

IKTK vijoi forcimin e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare përmes realizimit dhe ndjekjes së të paktën 9 marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit me universitete, institucione kërkimore dhe organizata kulturore brenda dhe jashtë vendit. Bashkëpunimet

përfshijnë projekte për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore, konservimin, restaurimin, kërkimin shkencor dhe zhvillimin e platformave digjitale për muze dhe site arkeologjike.

3. Programe shtetërore dhe ndërkombëtare në trashëgimi kulturore

Në kuadër të programeve shtetërore dhe ndërkombëtare, IKTK zhvilloi bashkëpunime me 4 institucione dhe organizata ndërkombëtare, përfshirë INRAP, CNRS–Sorbonne Paris IV dhe European Centre for Byzantine and Post Byzantine Monuments. Programet u fokusuan në inventarizimin e trashëgimisë, konservimin e pikturave murale dhe shkëmbimin profesional në fushën e restaurimit dhe arkeologjisë.

4. Marrëdhënie me UNESCO-n

Në kuadër të marrëdhënieve me UNESCO-n dhe zbatimit të Konventës së Trashëgimisë Botërore, u realizuan 2 raporte mbi gjendjen e konservimit për pasuritë botërore Berat–Gjirokastrë dhe Rajonin e Liqenit të Ohrit. Gjithashtu u hartua drafti final i Planit të Menaxhimit të Integruar për qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë dhe u organizua 1 ëorkshop prezantues për planin.

5. Aktiviteti i IKTK-së sipas Planit 4-M-I

Në kuadër të Planit të Punës 4-M-I për vitin 2026, IKTK realizoi 4 ndërhyrje konservuese dhe restauruese në monumente me vlera të veçanta kulturore. Ndërhyrjet përfshinë restaurimin e pikturave murale, ikonostaseve dhe mozaikëve në monumente të rëndësishme si Manastiri i Ungjillizimit në Vanistër, Manastiri i Shën Marenës në Llëngë, Antigonea dhe Parku Arkeologjik i Butrintit.

6. Monitorime dhe projekte arkeologjike

Gjatë vitit 2026 u realizuan 25 monitorime arkeologjike për subjekte private të licencuara, si dhe një sërë projektesh kërkimore dhe gërmimesh arkeologjike në zona të ndryshme të vendit. Aktivitetet përfshinë projekte konservimi, sondazhe dhe gërmime në Belsh, Divjakë, Lushnjë, Mat, Maliq, Zadrimë, Gjirokastrë dhe Tiranë, në bashkëpunim me institucione akademike, muze dhe bashki vendore.

7. Sekretaria Teknike e KKTKM

Sekretaria Teknike e KKTKM vijoi publikimin e vendimeve, regjistrave publikë dhe njoftimeve në faqen zyrtare të IKTK-së, si dhe përfundoi në masën 100% implementimin e sistemit e-leje. Gjithashtu u realizua integrimi i mandat pagesave për shërbimet online të ofruara në portalin e-albania.

8. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe kërkimi shkencor

IKTK mbështeti programet për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet rritjes së aplikimeve dhe financimit të kurseve të trajnimit dhe atelieve të restaurimit të propozuara nga Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore, me synim rritjen e numrit të specialistëve të trajnuar në fushën e trashëgimisë kulturore.

9. Botime dhe promovime

Në kuadër të veprimtarisë botuese për vitin 2026, IKTK planifikoi publikimin e 2 revistave shkencore periodike: “Monumentet” Nr. 65 dhe “Arkeologjia” Nr. 3, me fokus promovimin e studimeve dhe kërkimeve në fushën e trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë.

10. Digjitalizimi i arkivit të IKTK-së

